

BULETINI I IGJK-së qershor 2006

Ky Buletin është publikuar për informim sa më të plotë të gjyqësisë së Kosovës rreth veprimtarisë së Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGJK). Ky publikim iu është shpërndarë gjyqtarëve dhe prokurorëve në gjithë Kosovën. Buletini mujor i IGJK-së tani përmban artikuj në lidhje me çështjet me interes për gjyqtarët dhe prokurorët që punojnë në Kosovë.

Osman Tmava
gjykatës i Gjykatës Supreme të Kosovës

DËSHMITARËT E TESTAMENTIT

HYRJE

Ligji për Trashëgimin (LT) në nenin 2 parasheh se pasuria trashëgimore e trashëgimlënësit, në trashëgimtar të tij kalon në bazë të ligjit dhe në bazë të testamentit.

Testamenti paraqet shprehjen e vullnetit të fundit të trashëgimlënësit-testatorit, e cila jepet në formën e paraparë me ligj me çka testatori edhe urdhëron si të veprohet me pasurinë e tij pas vdekjes së tij (neni 69.1. LT).

Duke pasur parasysh këtë përkufizim ligjor, del se testamenti është një punë juridike me efekt pas vdekjes, se është punë juridike lukrative (bëmirëse), është punë juridike e njëanshme, ekskluzivisht personale, formale dhe e revokueshme.

Në këtë drejtim për vlefshmërinë e testamentit rol të rëndësishëm te disa forma të testamentit ka edhe prezenca e dëshmitarëve.

Ky fakt paraqitet me qëllim të realizimit në masë më të madhe të sigurisë juridike.

PREZENCA E DËSHMITARËVE TE TESTAMENTIT

Si u theksua edhe më lart prezenca e dëshmitarëve te disa forma të testamentit paraqitet e rëndësishë së veçantë dhe si e domosdoshme. Ky kusht paraqitet si në fazën e cila i paraprinë përpilimit të testamentit, me rastin e përpilimit të testamentit por dhe me rastin e shpalljes së përmbajtjes së testamentit.

Kështu duke pasur parasysh situatat e më larta del që paraqiten tri grupe të dëshmitarëve të testamentit dhe atë: 1. dëshmitarët e identitetit, 2. dëshmitarët e testamentit dhe 3. dëshmitarët e shpalljes së testamentit.

1. Dëshmitarët e identitetit.

Dëshmitarët e identitetit të trashëgimlënësit paraqiten te disa forma të testamentit dhe atë në fazën paraprake, para përpilimit të testamentit, konkretisht paraqiten te format zyrtare-publike të shprehjes së vullnetit të fundit të testatorit (testamenti gjyqësor, ndërkombëtar, konzular, në anije dhe testamenti ushtarak), me ç'rast gjyqtari-presoni zyrtar i cili merë pjesë në përpilimin e testamentit ka detyrim të konstatojë në procesverbal paraprakisht identitetin e pjesëmarrësit në procedurës përkatësisht testatorit pra para se të fillojë me përpilimin e testamentit.

Ekziston vetëm një rast kur vërtetimin e identitetit të testatorit nuk ka nevojë të jenë prezent dëshmitarët përkatësisht është rasti kur gjyqtari-presoni zyrtar e njeh personalisht testatorin. Në situatën kur gjyqtari-personi zyrtar nuk e njeh personalisht testatorin na paraqiten dy situata-alternativa: 1. testatori posedon dokument publik me fotografi të cilën e ka nxjerrë organi publik dhe 2. kur testatori nuk posedon dokument publik me fotografi, identiteti i tij vërtetohet me konstatimet e identitetit që e bëjnë dy dëshmitar.

2. Dëshmitarët e testamentit

Te format më të shpeshta, të testamenteve të bëra është e nevojshme prezenca e dëshmitarëve. Kështu pra pjesëmarrja e dëshmitarëve paraqitet si një *condicio sine qua non* për vlefshmërinë e testamentit. Ky kusht paraqitet te situatat te testamentet me shkrim ai ndërkombëtar dhe ai gojor. Me këtë do t'i shkoqisin vetëm disa çështje themelore për rolin e dëshmitarëve te disa forma të testamenteve.

Dëshmitarët e identitetit janë lloj i veçantë i dëshmitarëve dhe dallohen nga dëshmitarët tjerë, sidomos nga dëshmitarët e testamentit. Këta dëshmitar mund të jenë edhe personat e interesuar për përmbajtjen e testamentit, pra të afërmit e testatorit dhe pasardhësit e tij, etj.

Te dëshmitarët e identitetit nuk paraqitet kushti që ata të dinë shkrim-lexim, pra mund të jenë edhe analfabet, kjo nga arsyeja se ata dëshmitar me asnjë veprim të tyre nuk janë të lidhur me përmbajtjen e testamentit apo ndonjë veprim tjetër lidhur me përpilimin e testamentit.

Dëshmitarët e identitetit si dhe kategoritë tjera të dëshmitarëve duhet të plotësojnë kushte të përgjithshme të përshtatshmërisë për të qenë dëshmitar pra duhet të jenë të moshës madhore dhe të kenë zotësinë e plotë të veprimit.

Detyra e dëshmitarit të identifikimit përfundon me rastin kur në fazën e caktuar të procedurës në kërkesë të gjykatës-personit zyrtar, këta vërtetojnë identitetin e testatorit dhe e nënshkruajnë procesverbalin. Është i rëndësishëm fakti se dëshmitarët e identitetit munden nëse kushtet ligjore lejojnë, të jenë edhe dëshmitar të testamentit.

Testamenti me shkrim në prani të dëshmitarëve (alografik).

Testamenti alografik përkufizohet në nenin 75 të Ligjit për Trashëgimin, si testament me shkrim në prani të dëshmitarëve.

Te kjo formë e testamentit roli i dëshmitarëve është i shumëfishtë, konkretisht të dy dëshmitarët në të njëjtën kohë duhet të prezantojnë në aktin e nënshkrimit të testamentit nga ana e testatorit, të dy

dëshmitarët duhet të dëgjojnë dhe kuptojnë deklaratën e testatorit se ai pohon dhe vërteton se e ka lexuar, se ai është testamenti i tij dhe dëshmitarët njëherit duhet të kuptojnë gjuhën e testamentit dhe të e nënshkruajnë atë.

Rezulton se testatori duhet të nënshkruan testamentin me dorën e vet. Pra del që testatori duhet të dinë shkrim-lexim. Kjo është e nevojshme nga arsyeja se ai duhet të lexojë testamentin i cili përpilohet sipas tregimit të tij nga ana e personit të tretë. Ky fakt është i rëndësishëm edhe për atë sepse pas përpilimit të testamentit më nuk ka mundësi që testamenti të konvalidohet.

Testamentin duhet ekskluzivisht personalisht ta nënshkruaj testatori apo te vejë gjurmën e gishtit. Kështu ai shënon emrin dhe mbiemrin apo nënshkrimin apo nënshkrim që e përdorë zakonisht në qarkullimin juridik. Nënshkrimi blanko pa tekst të testamentit është i pavlerë si dhe testamenti i përpiluar më vonë. Prezenca e dëshmitarëve është e detyrueshme për arsye se ata në mënyrë të drejtpërdrejt vërtetojnë se testatori ka nënshkruar testamentin, pra e vërtetojnë autentitetin e nënshkrimit të testamentit. Nënshkrimi i testatorit vihet në fund të testamentit dhe nën te shkruhet data, vendi i përpilimit të testamentit dhe nënshkrimi i dëshmitarit. Nëse testamenti ka shumë fletë atëherë testatori i nënshkruan të gjitha fletët veç e veç.

Çdo konstatim nën nënshkrimin e testatorit nuk paraqet përmbajtje të testamentit. Pranimi i përmbajtjes së testamentit nga testatori duhet të jetë shprehimor mirëpo edhe mund të pranohet të bëhet me veprime

konkludente. Pra edhe pa deklaram formal se pranon përmbajtjen testatori pasi i dikton testamentin personit të tretë, e merë dhe e lexon testamentin dhe në prezencë të dy dëshmitarëve atë e nënshkruan. Testamenti është i vlefshëm për arsye se përmbajtja e tij për dëshmitar është irelevante sepse ata vërtetojnë vetëm faktin e nënshkrimit dhe që ai fakt edhe paraqet vullnetin e tij.

Sa i përket cilësisë së personalitetit të dëshmitarit rezulton se çdo person nuk është i përshtatshëm për me qenë dëshmitar i testamentit. Në këtë drejtim duhet plotësohen kushte të përgjithshme si edhe te dëshmitarët e identitetit pra dëshmitari duhet jetë i moshës madhore dhe të ketë zotësinë e veprimit, por njëherit duhet të plotësoj edhe një kusht të veçantë, të din shkrim dhe lexim, kjo nga arsyeja të kuptohet në masë të duhur gjuha e testamentit. Në këtë kontekst rezulton se personat e verbër nuk janë të përshtatshëm për të qenë dëshmitar të testamentit. Sa i përket personave memec ata mund të jenë dëshmitar me kusht që të ekzistoj mundësia që përmes interpretit të lexohet nga lëvizjet me gojë .

Testatori testamentin mund të e ruan te çdo person fizik apo juridik, pra mundet në këtë detyrë me qenë edhe dëshmitari i testamentar.

Edhe revokimi i testamentit është analog me procedurën e përpilimit të testamentit ku me atë rast dëshmitar mund të jenë ata të cilët ishin prezent me rastin e përpilimit të testamentit por munden me qenë edhe persona të tjerë.

Dëshmitarët te testamenti gojor

Trashëgimlënësit në situata të caktuara nga shkaku i rrethanave të jashtëzakonshme i pamundësohet të lënë testament në formën me

shkrim. Në këto situata testatori fton dy dëshmitar si përcakton ligji, për me qenë prezent në çastin e shprehjes së vullnetit të tij

të fundit. Me këtë rast rrethi i dëshmitarëve nuk është i caktuar, pra mundet me qenë në cilësi të dëshmitarit çdo person që i plotëson kushtet e përgjithshme për të qenë dëshmitar çka edhe vlen edhe për dëshmitarët e cekur më lart. Te kjo kategori e dëshmitarëve nuk kërkohet ndonjë kusht i veçantë si p.sh. të dinë shkrim dhe lexim. Dëshmitarët që janë prezent nuk mund të pranojnë asnjë interes material nga testatori nga çdo bazë qoftë e testamentit. Kjo vlen edhe për pasardhësit, paraardhësit, personat në gjini të tërthorët deri në shkallën e katërt, bashkëshortët e atyre personave, bashkëshorti i testatorit, etj. (neni 79.2 i LT). Detyra e dëshmitarëve është që pa shtyrje të shkruajnë deklaratën e vullnetit të fundit të testatorit dhe sa më parë atë të e dorëzojnë në

gjykatë apo që në gjykatë me gojë të përsërisin deklaratën e vullnetit të fundit të testatorit. Këtë veprim dëshmitarët duhet të e bëjnë në afat prej 30 ditësh duke filluar nga dita e pushimit të rrethanave të jashtëzakonshme. Nëse dëshmitarët e testamentit gojorë janë të pandërgjegjshëm në kryerjen e detyrimit të tyre, pra vonohen dhe në ndërkohë shqyrtohet trashëgimia sipas bazës ligjore atëherë do të vërtetohet ekzistimi i testamentit gojorë sepse fakti i pa ndërgjegjshësisë së dëshmitarëve nuk mund të sjellë pavlefshmërinë e testamentit. Në këtë rast nëse trashëgimtari ligjor, me mirëbesim e shet një pjesë të pasurisë trashëgimore, dëshmitarët mbajnë rrezikun për dëmin e shkaktuar atë ta shpërblejnë trashëgimtarët testamentar.

Dëshmitarët te testamenti gjyqësor.

Te testamenti gjyqësor si edhe te testamentet të cilat përpilohen sipas rregullave të testamentit gjyqësor (ai konzular, në anije dhe testamenti para eprorit ushtarak-testamenti ushtarak), dëshmitarët parimisht nuk janë të nevojshëm. Testamenti gjyqësor përpilohet nga gjykatësi-personi zyrtar sipas diktimit të testatorit. Në situata të caktuara është e nevojshme edhe prezenca e dëshmitarit. Prezenca e dëshmitarëve kushtëzohet me faktin se testatori a din apo nuk din shkrim dhe lexim.

Në rast se testatori din shkrim dhe lexim prezenca e dëshmitarëve nuk është e nevojshme. Mirëpo në situatën kur testatori nuk din shkrim dhe lexim, nuk mundet, nuk është në gjendje të lexoj apo të nënshkruaj

testamentin e vet atëherë është e nevojshme prezenca e dy dëshmitarëve. Prezenca e këtyre dëshmitarëve është pjesë, element i formës dhe mos ekzistimi i tyre sjell pavlefshmërinë e testamentit. Dëshmitarët e testamentit nuk është e nevojshme të njohin testatorin, që kjo është kusht për dëshmitarët e identitetit. Dëshmitarët e testamentit alografik nuk ka nevojë të njoftohen me përmbajtjen e testamentit kurse te testamenti gjyqësor dëshmitarët njoftohen me përmbajtjen e testamentit . Dëshmitarët e testamentit është kusht të dinë shkrim-lexim, të lexojnë dhe kuptojnë gjuhën e testamentit çka ky kusht i veçantë nuk paraqitet te dëshmitarët e identitetit .

Përshtatshmëria e dëshmitarëve testamentar.

Përshtatshmëria e dëshmitarëve paraqitet si element i vlefshmërisë së testamentit. Pa përshtatshmëria paraqitet në dy forma: 1. absolute e cila i përket një kategorie të

personave të cilat pavarësisht llojit dhe karakterit të marrëdhënieve me

testatorin nuk mund të jenë në cilësinë e dëshmitarëve. Kjo mundet me qenë: a). e përgjithshme dhe i përket personave të moshës jo madhore dhe personave të cilët nuk e kanë zotësinë e veprimit dhe b).e veçantë e cila paraqitet vetëm te disa forma të testamentit p.sh. dëshmitar nuk mundet me qenë personi që nuk din shkrim e lexim te rasti i testamentit gjyqësor dhe ata të ngjashëm me te , por nuk mund me qenë as personat të cilët nuk flasin gjuhën në të cilën është përpiluar testamenti. Kjo vlen njëjtë edhe te testamenti ndërkombëtar . Te testamenti alografik , dëshmitarët duhet të din të shkruajnë dhe të lexojnë në gjuhën në të cilën testatori e pranon testamentin. Këta dëshmitar nuk kanë nevojë të njoftohen, të dijnë për përmbajtjen e testamentit. Te testamenti gojorë dëshmitarët nuk është e thënë të dinë shkrim dhe lexim por duhet të dinë gjuhën në të cilën testatori e ka shpreh vullnetin e tij të fundit. Në cilësi të dëshmitarit me kusht të plotësohen kushtet ligjore mundet me qenë çdo qytetar i Kosovës apo qytetar i huaj. Përveç kategorisë së parë të papërshtatshmërisë-absolute ekziston edhe papërshtatshmëria relative e dëshmitarëve

testamentar të cilët i përkasin kategorisë së personave që për shkak të marrëdhënieve të caktuara me testatorin nuk munden me qenë në cilësi të dëshmitarit dhe në këtë grup bëjnë të gjithë personat që potencohen në nenin 79.2 të LT, e të cilët i përkasin pasardhësve, paraardhësve të testatorit etj.

Detyra e dëshmitarit testamentar.

Dëshmitarët e testamentit dallohen nga kategoria e dëshmitarëve në kuptim të Kodit të Procedurës Penale apo të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Për të qenë dëshmitar testamentar një cilësi e tillë nuk paraqet detyrim qytetar dhe mos përmbushjen e atij detyrimi nuk sjell deri te përgjegjësia përkatëse. Te situatat kur pa shtyrje duhet të përpilohet testamenti kurse mundësi të zgjidhjes të personit tjetër nuk ka atëherë cilësia e dëshmitarit të testamentit paraqitet si detyrim qytetar dhe personi përkatësisht dëshmitari i përgjigjet trashëgimtari testamentar për dëmet eventuale të cilat ai i pëson.

3. Dëshmitarët e shpalljes së testamentit

Pas vdekjes së testatorit me rastin e shpalljes së përmbajtjes së testamentit duhet të prezantojnë dy dëshmitar. Këta dëshmitar nuk e kanë karakterin e dëshmitarëve testamentar. Për të qenë në cilësinë e dëshmitarit të shpalljes së testamentit duhet të plotësohet kushti i përgjithshëm, si edhe te kategoritë tjera të dëshmitarëve të testamentit, personi duhet të është i moshës madhore dhe mos t'i është marrë zotësia e veprimit. Dëshmitarët në fakt prezantojnë në një veprim zyrtar me të cilin gjykata shpallë ekzistimin e testamentit dhe

përmbajtjes së tij. Me atë rast nuk hyhet në vlefshmërinë e testamentit. Në cilësi të dëshmitarit munden me qenë çdo person, pra edhe kategoria e personave të cilët janë të interesuar për përmbajtjen e testamentit, të afërmit e testatorit etj. Pra në këtë cilësi mund të jetë edhe përkthyesi gjyqësor, procesmbajtësi përveç gjykatësit përkatësisht bashkëpunëtorit profesional i cili Udhëheq me seancën. Detyra e dëshmitarëve edhe këtu nuk është detyrë

Veprimtaritë trajnuese të IGJK-së qershor 2006

Seminar – Bashkëpunimi në mes të prokurorisë dhe policisë në rastet e trazirave
Duke pasur parasysh se në raste të trazirave duhet të ndërmerren veprime të shpejta dhe të koordinuara mirë në mes të këtyre organeve dhe institucioneve të ndryshme, IGJK me 01 qershor 2006 ka organizuar seminarin me temën e lartshënuar me qëllim të ngritjes së nivelit të bashkëpunimit në mes tyre në rastet e trazirave. Përfitues të këtij seminari ishin gjyqtarët e procedurës paraprake, prokurorët publik dhe policia. Në këtë seminar po ashtu u prezantua edhe Raporti i Sektorit për Monitorimin e Sistemit Ligjor në OSBE lidhur me “reagimin e sistemit të drejtësisë gjatë trazirave të marsit 2004 dhe përmbajtja e këtij raporti shërbejë si bazë për diskutime gjatë seminarit.

Tryezë diskutimesh – Aspekte praktike të trashëgimit të pasurisë trashëgimore
Kjo tryeze është mbajtur me 06 qershor 2006. Përfitues të kësaj tryeze ishin gjyqtarët e lëmisë civile. Kjo tryezë shtjelloj temat të cilat kishin të bëjnë me dëshmitarët testamentar, trashëgimin në bazë të testamentit, trashëgimin në bazë të ligjit dhe çështjet e tjera trashëgimore të ndërlidhura me raste nga praktika gjyqësore.

Tryezë diskutimesh – Format e reja të hetimeve, masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit
Me 08 qershor 2006 IGJK organizoi një trajnim me temën e lartshënuar. Përfitues të kësaj tryeze ishin gjyqtarët, prokurorët dhe policia. Gjatë kësaj tryeze u shqyrtuan masat e fshehta dhe teknike që i urdhëron prokurori publik, ato që i urdhëron gjyqtari i procedurës paraprake, rëndësia dhe efekti i tyre në procedurën hetimore.

Seminar për gjyqtarë porotë në rajonin e Prizrenit

Më datën 13 qershor 2006 IGJK organizoi seminarin e lartshënuar. IGJK në bazë të mandatit që ka përfshin edhe trajnimin e gjyqtarëve porotë dhe atë nëpër të gjitha rajonet e Kosovës. Në muajin qershor është mbajtur trajnimi i gjyqtarëve porotë në rajonin e Prizrenit. Trajnimi u përqendrua në aspektin praktik të zhvillimit të procedurave penale dhe civile përfshirë edhe disa aspekte të Kodit të etikës dhe Mirësjelljes Profesionale për gjyqtarët porotë

Seminar – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Me 15 dhe 16 qershor 2006 është mbajtur seminari lidhur me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përfitues të këtij seminari ishin gjyqtarët dhe prokurorët. Ky trajnim dha një pasqyrim të detajuar të zbatimit në praktikë të dispozitave të nenit 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me qëllim të ngritjes së njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës në drejtim të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Seminar – Roli i dëshmitarëve në procedurën penale

Me 21 qershor 2006 është mbajtur seminari me temën e lartshënuar. Përfitues të këtij seminari ishin gjyqtarët e lëmisë penale dhe prokurorët publik. Në këtë seminar është debatuar rreth dëshmitarëve në procedurën penale, mbrojtjes së dëshmitarëve bashkëpunues dhe të dëmtuarve sipas Kodit të Procedurës Penale. Poashtu në këtë seminar u debatua edhe për zbatimin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve nga ana e prokurorit dhe gjykatës.

Tryezë diskutimesh për Kodin e Etikës

Më datën 27 qershor 2006 IGJK organizoi një tryezë të diskutimeve me temën e lartshënuar. Gjatë vitit 2006 IGJK ka vazhduar me organizimin e tryezave që kanë të bëjnë me Kodin e etikës në të gjitha rajonet e Kosovës. Kësaj radhe përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët dhe prokurorët nga regjioni i Pejës. Ky trajnim kishte për qëllim që të jap një pasqyrim më të detajuar mbi përvojën dhe praktikën, ku pavarësia e gjyqtarëve mund të jetë brengosëse. Seminari u përqendrua në pozitën e gjyqtarit si një vendimmarrës personal apo si një vendimmarrës në kolegji.

Seminar – Mardhenjet kontraktuese dhe specifikat e tyre

Ky seminar është mbajtur me 29 qershor 2006. Përfitues të kësaj tryeze ishin gjyqtarët e lëmisë civile. Kjo tryezë shtjelloj qeshtjet lidhur me mos përmbushjen dhe pa mundësinë për përmbushjen e obligimeve, vonesën e debitorit, mjetet për sigurimin e përmbushjes së obligimeve, hipotekën dhe pengun. Me këtë rast përmes diskutimeve interaktive u bene përpjekje për përmirësimin dhe harmonizimin e praktikës gjyqësore.

Ngjarjet e ardhshme korrik 2006

Njohja dhe Ekzekutimi i Vendimeve Penale

Grupi përfitues: gjyqtarët dhe prokurorët
Qëllimi i këtij trajnimi është që të inicioi diskutime për shkëmbim të informatave dhe unifikim të praktikave ekzistuese. Do të ketë edhe informata rreth përvojave ekzistuese për ndihmën juridike nga agjensionet e huaja dhe organet publike të cilat janë kompetente në fushën e çështjeve penale. Këto probleme po e dëmtojnë efikasitetin e sistemit gjyqësor në Kosovë. Ekzistimi i vendimeve penale është parë si një nga pengesat e zbatimit të procedurave të cilat janë garanci për një gjyqësi efektive.

Data e planifikuar: 04 korrik 2006

Seminar, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Grupi përfitues: gjyqtarët dhe prokurorët e rajonit të Mitrovicës

IGJK do të organizoi një trajnim nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rajonin e Mitrovicës. Ky është një sesion

dy-ditor i cili mëton që të jap një pasqyrim të detajuar drejt zbatimit të dispozitave të neneve 5 dhe 6 të kësaj konvente, me qëllim të ngritjes së njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve Kosovar drejt praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Katër trajnues vendor (gjyqtar dhe prokuror një nga ta nga minoriteti Serb) të cilët janë certifikuar nga Këshilli i Evropës do të veprojnë në cilësinë e trajnuesve në këtë sesion.

Data e planifikuar: 05 dhe 06 korrik 2006

Trajnim për gjyqtarët për Kundërvajtje

Gjatë vitit 2006 IGJK do të vazhdoi organizimin e sesioneve të posaçme trajnuese për gjyqtarët për kundërvajtje. Sesioni i tretë trajnues i këtij viti do të përqendrohet në procedurën kundërvajtëse me theks të veçantë në përgjegjësinë kundërvajtëse, bashkëpërgjegjësinë e personave fizik dhe juridik dhe mbledhja e dëshmive gjatë procedurës.

Data e planifikuar: 12 korrik 2006

Trajnimet e planifikuara nga IGJK deri ne fund të vitit

KORRIK 2006

- 04 korrik** Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve penale
- 05 dhe 06 korrik** Regjioni i Mitrovices: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e te Drejtave dhe Lirive te Njeriut (**KiE + IGJK**)
- 12 korrik** Trajnim për gjyqtaret e gjykatave për Kundërvajtje

SHTATOR 2006

- 04 dhe 05 shtator** Regjioni i Prishtines: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e te Drejtave dhe Lirive te Njeriut (**KiE + IGJK**)
- 07 shtator** Regjioni i Gjilanit: Simulim nga lëmia civile
- 12 shtator** Tryezë diskutimesh: Konfiskimi, procedura e konfiskimit
- 19 shtator** Regjioni i Mitrovicës: Tryezë diskutimesh mbi Kodin e Etikes
- 21 shtator** Regjioni i Prizrenit: Simulim nga lëmia penale
- 22 shtator** Sesion trajnues: Hetimi dhe gjykimi i veprave penale të ndërlidhura me korrupsionin (**KiE – IGJK**)
- 26 shtator** Regjioni i Pejës: Seminar për gjyqtaret porot
- 28 shtator** Procedura e shpalljes se personit te zhdukur si te vdekur

TETOR 2006

- 02 dhe 03 tetor** Regjioni i Gjilanit: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e te Drejtave dhe Lirive te Njeriut (**KiE + IGJK**)
- 04 tetor** Regjioni i Pejës: Simulim nga lëmia civile
- 10 tetor** Tryezë diskutimesh: Parashkrimi i ndjekjes penale
- 12 tetor** Tryezë e diskutimeve: Ekzekutimi i vendimeve civile
- 17 tetor** Trajnim për gjyqtarët e gjykatave për kundërvajtje
- 19 tetor** Tryeze diskutimesh: Ankesa, procedura sipas ankesës

26 tetor Risit e Ligjit për Familjen

NËNTOR 2006

02 nëntor Regjioni i Prishtinës: Simulim nga lëmia civile

03 dhe 04 nëntor Regjioni i Prizrenit: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e te Drejtave dhe Lirive te Njeriut (KiE + IGJK)

07 nëntor Tryezë diskutimesh: Mbrojtja e viktimave te trafikuar, sipas standardeve ndërkombëtare dhe KPPPK

09 nëntor Regjioni i Gjilanit: Seminar për gjyqtarët porot

15 nëntor Regjioni i Mitrovicës: Simulim nga lëmia penale

17 nëntor Seminar nga e drejta administrative.

21 nëntor E drejta sendore – Pronësia

23 nëntor Trajnim në formë të tryezës së diskutimeve lidhur me:
a) interpretimin dhe udhëheqjen e rasteve
b) udhëheqjen e gjykatores (KiE – IGJK)

24 nëntor Sesion trajnues lidhur me hartimin e vendimeve gjyqësore (KiE – IGJK)

30 nëntor Regjioni i Prishtinës: Tryezë diskutimesh mbi Kodin e Etikes

DHJETOR 2006

4 dhe 5 dhjetor Regjioni i Pejes: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e te Drejtave dhe Lirive te Njeriut (KiE + IGJK)

06 dhjetor Trajnim për gjyqtarët e gjykatave për kundërvajtje

11 dhjetor Trajnim në formë të tryezës së diskutimeve rreth zgjidhjes alternative të rasteve. (KiE – IGJK)

12 dhjetor Trajnim rreth caktimit të sanksioneve alternative në vend të dënimit me burgim (KiE – IGJK)

14 dhjetor **Tryezë Diskutimesh:** Procedura për kompensimin e dëmit, rehabilitim dhe për ushtrimin e te drejtave tjera te personave të dënuar ose arrestuar pa arsye

